



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.37/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit N.T.P “Xh...” Sh.P.K. me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “....” me adresë ....., Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti klasifikim tarifor, vlerë kontesti 10,955.59€, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur me datë 14.10.2022, në prani të autorizuarit të palës paditëse G.B nga Shoqëria e Avokatëve “....” - Prishtinë dhe në prani të të autorizuarit të palës së paditur M.K, mori, këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “N.T.P “Xh...” Sh.P.K. me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “....” SHPK, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.07.3/1096/2015 i datës 14.05.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 24.06.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit nr. 03.3/1096/2015 të datës 14.05.2019, i të paditurës

Dogana e Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të kodit Doganor, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Përfaqësuesja e palës paditëse si në padi, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe pranë të gjitha të cekura në të. E paditura kur ka lëshuar vendimin e kontestuar nuk i është përmbajtur vërejtjeve të gjykatës së shkallës së parë e cila sipas aktgjykimit A.nr.2167/15 të datës 05.03.2019 ka cekur të gjitha vërejtjet të cilat e paditura do të duhej të ishte përgjigjur, por e paditura nuk e ka kryer një obligim të tillë sipas ligjit. E paditura edhe pse do të duhej të kishte nxjerrë një mendim të ri tarifor, në aktvendimin e kontestuar ka cekur se Sektori i Tarifës përsëri i është përgjigjur kërkesës së Sektorit të Rishqyrtimeve duke i dërguar përsëri të njëjtin mendim tarifor ashtu siç dhe ka ndodhur edhe gjatë shqyrtimit të parë të kësaj çështje. Gjithashtu, e paditura do të duhej të deklarohet edhe në lidhje me provat e paditësit, përkatësisht deklaratën eksportuese, por edhe të këtë vërejtje të gjykatës nuk e ka marrë parasysh dhe nuk i është përgjigjur. E paditura përsëri në kundërshtim me nenin 72 dhe 265 të KDA-së e cila e obligon që përpara se të ndryshojë një numër tarifor duhet të ketë provat e mallit lëndor, përsëri e paditura për një mall i cili ka dalë në qarkullim të lirë nuk ka pasur asnjë mostër të mallit lëndor, e ka ndryshuar numrin tarifor dhe aq më tepër kur mendimi tarifor në të cilin është bazuar vendimi i kontestuar është për një subjekt tjetër dhe nuk është nxjerrë për paditësin. Konsiderojmë se vendimi i të paditurës është jo i drejtë, jo i bazuar ligjërisht dhe jo i bazuar në rekomandimet që i ka dhënë gjykata e cila lëndën e ka kthyer përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës me qëllimin për të evituar të metat të cilat gjykata i ka vërejtur gjatë shqyrtimit të kësaj çështje. Konsiderojmë se kjo çështje ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet pretendimi i paditësit se numri tarifor i deklaruar gjatë procedurës së zhdoganimit i cili është cekur edhe në Deklaratën Eksportuese ka qenë numri i duhur, dhe me ndryshimin e numrit tarifor e paditura e ka obliguar në mënyrë të padrejtë paditësin të paguaj taksë importuese më tepër se sa realisht do duhej të kishte paguar. Kërkon nga gjykata që pas verifikimit të gjendjes faktike, shkresave të lëndës, të marrë një vendim të drejtë dhe meritore duke aprovuar si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe duke anuluar aktvendimin e kontestuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 11.09.2020 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marrë komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë komfor legjisllacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i propozojmë gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi e palës së paditur deklaroi se: e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke mbetur në tërësi pranë aktvendimit të kontestuar. Gjithashtu, gjatë rishqyrtimit të lëndës sipas aktgjykimit të gjykatës A.nr.2167/2015 të datës 05.03.2019, Dogana e Kosovës-Spektori i Rishqyrtimeve ka marrë për bazë të gjitha vërejtjet e gjykatës kur e ka nxjerrë tani vendimin e kontestuar. Sa i përket vërejtjes së parë të gjykatës se paditësi ka sjellë dëshmi Deklaratën Eksportuese që dëshmon kodin tarifor të mallit të deklaruar, Dogana e Kosovës sqaron subjektin se për kod tarifor Spektori i Tarifës ka dhënë sqarim duke theksuar se klasifikimi tarifor i mallrave bazohet në TARIK. Gjithashtu, vërejtja e dytë që lidhet edhe me pretendimin e këtu paditësit ku është kërkuar nga Dogana të nxjerrët mendim i ri tarifor lidhur me mallin lëndor, Spektori i Rishqyrtimeve ka kërkuar nga Spektori i Tarifës mendim mbi klasifikimin tarifor dhe ka marrë përgjigje nga Spektori i Tarifës se mbesim pranë mendimit sikurse në mendimin tarifor 69/04.06.2014. Është praktikë e Spektorit të Tarifës që për mallra identike të mos nxjerrën mendime të tjera, por një mendim tarifor sikurse ky në rastin konkret mund të vlejë edhe për të gjitha mallrat identike të tjera pavarësisht se nga kush importohen, e sidomos në rastet kur ndryshimi i kodit tarifor aplikohet pasi që mallrat lirohen në qarkullim të lirë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.10.2022, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimet nr.1096/2015 i datës 14.05.2019, nr.1096/10.11.2015, nr.923 ose nr. prot.623/13.10.2015, nr.2019-618/2 i datës 22.05.2019, DUD-at R-3323/26.04.2014, R-18574/01.07.2014, R-23091/12.08.2014, R-31947/30.10.2014, R-24699/09.09.2015, R-12355/13.06.2014, R-6318/02.06.2014, R-2137/24.03.2014, R-38281/30.12.2014, R-17570/28.09.2015, Deklaratat EX1, Certifikatat e Origjinës, Faturat e datës 24.10.2014,

23.06.2014, 19.03.2014, 06.08.2014, 22.04.2014, 02.04.2019, 19.10.2015, 21.11.2014, 29.12.2014, Përgjigja në Padi e datës 11.09.2020, e-mailat e datës 14.05.2019, 13.05.2019, 15.04.2019 të Doganës së Kosovës, Mendimi për Klasifikim Tarifor nr.69/04.06.2014, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës nr.1096/02.11.2015, Procesi për marrjen e Mostrave i datës 09.10.2015, Autorizimi për Kontroll i datës 09.10.2015, Kartelat e Artikullit,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura me datë 13.10.2015, ka nxjerr aktvendimin nr.05.1/923, me të cilin ka ndryshuar kodet tarifore të deklaruara nga vet pala këtu paditësi dhe e ka obliguar të njëjtin me detyrime shtesë për DUD-at kontestues, R-2137/24.03.2014, R-3323/26..04.2014, R-18574/01.07.2014, R-23091/12.08.2014, R-31947/30.10.2014, R-24699/09.09.2015, si në këtë Aktvendim. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës fillimisht ka sjell Aktvendimin 07.3/1096 të datës 10.11.2015, pastaj në ri-procedurë sipas aktgjykimit A. nr. 2167/15, me datë 14.05.2019, ka sjell Aktvendimin nr.07.3/1096/2015, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.07.3/1096 të datës 10.11.2015 të Sektorit të Kontrollës Pas Importuese.

Nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, del se e paditura Dogana e Kosovës – fillimisht Sektori i Kontrollit pas Importues duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka iniciuar kontrollin dokumentar ndaj paditësit, për shqyrtimin e kodit tarifor të

mallit “Profile alumini ndarëse i mbushur me poliuretan”. Si rezultat i kësaj e paditura - Sektori i Kontrollit Pas Importues, duke u bazuar edhe në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr. 04.3nr.69/04.06.2014, të dhënë nga Sektori i Tarifave i cili vepron në kuadër të paditurës, ka ardhur në përfundim se paditësi me DUD-at kontestues R-2137/24.03.2014, R-3323/26..04.2014, R-18574/01.07.2014, R-23091/12.08.2014, R-31947/30.10.2014, R-24699/09.09.2015, me rastin e zhdoganimit, nuk e ka deklaruar saktë kodin tariforë të mallit “profile alumini për roleta” dhe llogaritjen e taksave në rubrikën 47, ngase mallin e ka deklaruar në numrin-kodin tarifor 760429900, numër ky i cili e ka liruar mallin nga taksa doganore prej 10% dhe TVSH-ja, ndërsa sipas Mendimit për Klasifikimin Tarifor si më lartë është dashur të tarifohet në numrin-kodin tarifor 7610909020 për mallin sipas R-2137/24.03.2014, R-3323/26..04.2014, R-18574/01.07.2014, R-23091/12.08.2014, R-31947/30.10.2014, R-24699/09.09.2015, sipas të cilit kod tarifor për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% në vlerë prej 9,403.37€ dhe diferenca e TVSH-ës në shumë prej 1,552.22€, apo gjithsej taksa doganore prej 10,955.59€.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative, gjithmonë në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të BE-së, për mallin kontestues nga paditësi.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë konflikt administrativ Gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes DUD-ve kontestues, mbi bazën e të cilit deklarim paditësi është liruar nga pagesa e taksës doganore. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të autoriteteve nga shteti eksportues apo i origjinës të deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit dhe/apo shqyrtimit gjyqësor atëherë e paditura me të drejtë është bazuar në Mendimin për Klasifikim Tarifor nr. 69/04.06.2014, të dhënë nga Sektori i Tarifave për mallra identike apo të ngjashme i cili vepron në kuadër

të paditurës. Nuk është kontestues fakti se Informacioni tarifor i detyrueshëm gjen zbatim me nenin 18, par 1 dhe 2, të KDAK-së, dhe do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor të mallit, dhe se Informacioni tarifor i detyrueshëm është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata.

Gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1, pika C thuhet; *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar”*, konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura por edhe pranë Gjykatës të ofrojë prova konkrete *“informatë tarifore detyruese”* për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut aplikohet lirime nga detyrimet doganore

Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga vendi eksportues ose i origjinës së mallit, andaj Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestuese, për arsye se, e paditura Dogana e Kosovës referuar Mendimit për Klasifikim Tarifor nga Sektori i Tarifës nr. 69/04.06.2014, si sektor i specializuar i cili vepron në kuadër të paditurës, me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret malli lëndor është dashur të tariforet sipas përshkrimit *në numrin-kodin tarifor 7610909020*, sipas të cilit kod tarifor për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% dhe e TVSH-ja. Deri tek përfundim lidhur me klasifikimin e saktë tarifor e paditura ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për interpretimin e nomenklaturës së kombinuar të Unionit Evropian, shënimet shtesë të TARIK-ut dhe direktivës për interpretimin e nomenklaturës së mallrave në TARIK që përbehet nga shënimet sqaruese të sistemit të harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave.

Gjykata ka gjetur si jo të bazuar pretendimin e këtu paditësit lidhur me deklaratën eksportuese ku i njëjti mall sipas paditësit është paraqitur me numër tarifor të deklaruar si në këtë deklaratë, kjo për faktin se deklarata eksportuese përpilohet mbi bazën e faturës dhe të dokumenteve përcjellëse të mallit, dhe se e njëjta nuk është dokument për aplikim të preferencave tarifore në shtetin e destinimit, në këtë rast të Kosovës.

Sipas nenit 24 par.1 të KDA-së është paraparë që *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshmërisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor”*, dhe neni 18, të këtij Kodi ku thuhet se *“Dogana do të lëshojë informacion të detyrueshëm tarifor ose informacion të detyrueshëm të origjinës në bazë të kërkesës me shkrim, duke vepruar në përputhje me dispozitat për zbatimin e këtij Kodi andaj edhe nga kjo dispozitë del kompetenca e këtu të paditurës për të dhënë mendime tarifore për Doganën por edhe informata tarifore detyruese për palët. Tutje Kontrollimi i deklaratave pas zhdoganimit, mund të bëhet bazuar në nenin 82, par 1. të KDA-së, *“Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”*. Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin*

e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklarimit të pa saktë të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-at kontestues.

Si përfundim, Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 07.3/1096/2015 i datës 14.05.2019, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së,

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.37/2022, datë 14.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional  
Visar GASHI

Gj y q t a r i  
Fisnik NULI

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.